



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1916/1 Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

VENDIM

Nr. 98 dt. 30.11.2022

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIMIN PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË
PROMOVIMIT TË PËRSONELIT AKADEMIK TË UST-SË (KPPA)**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 5 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, V.K.M-së nr.112 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26, 27 të Statutit të UST-së, Rregullores së Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.11.2022,

VENDOSI:

Hapjen e thirrjes për vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së (thirrja bashkëngjitur).

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimi të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASHE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1916/12 Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

Lënda: Njoftim mbi vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik

Prof.Dr. _____

KËTU

Në zbatim të pikës 1 (gërma "i") të nenit 38, të pikës 3 dhe 5 të nenit 46 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH", i ndryshuar, VKM-së nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" i ndryshuar; gërmës "nj" të nenit 20 si dhe neneve 26, 27 të Statutit të UST-së, për krijimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si strukturë përgjegjëse për dhënien e titujve "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar",

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qënë anëtarë të këtij komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 27 të Statutit të UST-së. Rregjistrimin mund ta bëni në zyrën e Protokoll-Arkivës së UST-së, nga data 30.11.2022 deri brenda orës 16:00 të datës 07.12.2022 ose/dhe në adresën contact@ust.edu.al.

Mbetemi në pritje të vetkandidimeve tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e radhës, të Senatit Akademik, të për zgjidhen anëtarët, që do të formojnë Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirkuptimin!

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA

